

Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë, Fortlumturia e tij z. Joan po merr pjesë në Konferencën II Ndërkombëtare të Revistës “Θεολογία”



Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë, Fortlumturia e tij z. Joan po merr pjesë në Konferencën II Ndërkombëtare të Revistës “Θεολογία” me temë: “Teologjia Orthodhokse dhe ‘Ontologjia’ e Teknologjisë: Pasojat Antropologjike, Politike, Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore”

Kryepiskopi Joan shoqërohet në këtë aktivitet të rëndësishëm nga Mitropoliti i Korçës, Hirësi e Tij, Anastasi, Kryedhjakon Johan Korovesi, pedagogët z. Gjergji Mulla dhe z. Thoma Çomëni.

Fortlumturia ynë, imzot Joani dhe delegacioni shoqërues i Kishës sonë u prit në pikën kufitare të Kapshticës nga Mitropolitët: i Grevenasë Hirësia e Tij, z. David; i Kosturit, Hirësia e Tij, z. Kaliniku dhe i Siatistës, Hirësia e Tij, z. Athanasi.

Në Selanik, Kryepiskopi Joan, u takua miqësisht me Kryepiskopin e Greqisë, Jeronimin II dhe Patriarkun e Bullgarisë, Danielin.

Konferenca II Ndërkombëtare e organizuar nga Revista Teologjike “Θεολογία”, nën kujdesin dhe organizimin e Sinodit të Shenjtë të Kishës së Greqisë, zhvillohet në qytetin e Selanikut më 29 shtator -1 tetor 2025. Kjo konferencë përfaqëson një ngjarje të rëndësishme në kalendarin akademik dhe kishtar ndërkombëtar, duke

adresuar temën: “Teologjia Orthodhokse dhe ‘Ontologjia’ e Teknologjisë: Pasojat Antropologjike, Politike, Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore”.

Komiteti Organizues:

Kryetar i Konferencës është Fortlumturia e Tij, Jeronimi II, Kryepiskop i Athinës dhe i Gjithë Greqisë.

Anëtarë të Komitetit Organizues janë:

- Mitropoliti Doroteu i Siros
- Mitropoliti Krisostomi i Halkis
- Mitropoliti Nikolla i Mesogaia dhe Lavreotiki
- Mitropoliti Dionisi i Korinthit
- Mitropoliti Davidi i Grevenas
- Mitropoliti Platoni i Langadas, Liti dhe Rentina
- Mitropoliti Gregori i Peristerionit
- Mitropoliti Filotheu i Selanikut (Drejtor i Sektorit të Botimeve të Sinodit të Shenjtë të Kishës së Greqisë)

Sekretar: Dr. Aleksandri I. Katsiaras, Drejtor Redaksie i Revistës “Θεολογία”.

Konferenca po zhvillohet në praninë e:

- Tërëshenjtërisë së Tij, Patriarkut Ekumenik Bartolomeu I
- Fortlumturisë së Tij, Jeronimit II, Kryepiskop i Athinës dhe i Gjithë Greqisë, i cili do të mbajë fjalën përshëndetëse
- Primatëve të Kishave Orthodhokse të Bullgarisë, Qipros dhe Shqipërisë
- Delegacioneve zyrtare të Kishave Autoqefale Orthodhokse
- Përfaqësuesve të Autoriteteve Politike, Juridike të Greqisë

Fortlumturia e Tij, Imzot Joani, do të referojë mbi temën: “Tjetërsimi Digjital dhe Terapeutika Orthodhokse: Një Qasje Baritore ndaj Teknologjisë”.

Kjo konferencë përfaqëson një përpjekje serioze për të artikuluar një përgjigje teologjike dhe baritore ndaj sfidave të kohës moderne, ku teknologjia ndikon thellësisht, jo vetëm në jetën e përditshme të individit, por edhe në përkufizimin e vetë natyrës njerëzore dhe marrëdhënies me Zotin dhe tjetrin.

[Radio “Ngjallja”](#)